



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2024:181643

Datë: 11.10.2024

Numri i dokumentit: 06285544

P.nr.203/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË –Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Marigona LAJQI, me bashkëpunëtoren profesionale Arbenita DËRGUTI, në çështjen penale ndaj të akuzuarit A.SH., për shkak të veprave penale Sulmi nga neni 184 paragrafi 3 nënpar 3.1 e lidhur me par.1 dhe Sulmi nga neni 184 paragrafi 3 nënpar 3.1 e lidhur me par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (*tutje si: KPRK*), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.249/24 të datës 28.06.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 09.09.2024 në prezencë të Prokurorit të Shtetit Albana Parduzy, i pandehuri A.SH., mbrojtësi i tij sipas detyrës zyrtare, avokat L.T., me datë 11.09.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 11.10.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

A... SH..., nga i ati I..., nëna A..., e gjinisë, S... i lindur me datë ..., vendlindja M..., vendbanimi në rruga "...” M... ,me numër personal ..., shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën fillore, punëtor në "...” Mitrovicë, i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike.

ËSHTË FAJTOR

-I-

Sepse,

Më datë ... rreth orës min në Mitrovicë saktësisht në lagjen "...”, pranë çerdhes së fëmijëve "...”, në shtëpinë e tyre të përbashkët , me dashje përdorë forcën ndaj të dëmtuarës viktimës së ndjeshme –bashkëshortes B... Sh..., si pasojë e mosmarrëveshjes të atëçastshme lidhur me pagat, ashtu që fillimisht fillon ta ofendoj me fjalë fyese “k....., rr....., po shkon po q.....”, ti i ki 100 jarana, shkon me pare”, e pastaj edhe e kap me duar për fyti dy –tri herë

-Me këtë ka kryer veprën penale: Sulm nga neni 184 par.3 nen par 3.1 e lidhur me par.1 të KPRK-së.

-II-

Më datë ... rreth orës ... min në Mitrovicë saktësisht në lagjen “...” ,pranë çerdhes së fëmijëve “...” ,në shtëpinë e tyre të përbashkët ,me dashje përdorë forcën ndaj të dëmtuarës viktimës së ndjeshme –vajzës R... Sh.. si pasojë e mosmarrëveshjes të atëçastshme ashtu që gjer sa dëmtuara i sheh duke u fjalosur të dëmtuarën- nënën B... Sh.. dhe të pandehurin- prindin , hynë në mes dhe tenton që ti ndaj, në atë moment i pandehuri nga nervoze e godet me grusht në shpinë,

-Me këtë ka kryer veprën penale: Sulm nga neni 184 par.3 nen par 3.1 e lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë të neneve: 1, 4, 7, 17, 21, 38, 40, 42, 46, 47, 48, 49, 69, 70, 76, e lidhur me nenin 184 par.1 të KPRK-së dhe neneve 364, 449, 452 dhe 462 të KPP-së, të akuzuarit, i:

G J Y K O N

I.Për veprën penale: Sulm nga neni 184 par.3 nen par 3.1 e lidhur me par.1 të KPRK-së, me DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej tetë (8) muajve.

II. Për veprën penale: Sulm nga neni 184 par.3 nen par 3.1 e lidhur me par.1 të KPRK-së, me DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve.

Në bazë të nenit 76 të KPRK-së, të akuzuarit, i:

S H Q I P T O N

I. DËNIM UNIK ME BURGIM në kohëzgjatje prej dymbëdhjetë (12) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet menjëherë pas plotëfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

- II.** I akuzuari obligohet që në emër të shpenzimeve procedurale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej njëzetë (20) euro, në emër të fondit të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej njëzet (20) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykim.
- III.** Të dëmtuarat, B... Sh... me vendbanimi rr. “...” M..., dhe R... SH.... vendbanim rruga “...” M..., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur Aktakuzën PP.II.nr.249/2024 të datës 28.06.2024 kundër të pandehurit A.SH., për shkak të veprave penale Sulmi nga neni 184 paragrafi 3 nënpar 3.1 e lidhur me par.1 të KPRK-së dhe Sulmi nga neni 184 paragrafi 3 nënpar 3.1 e lidhur me par.1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 09.09.2024, në të cilën kanë prezantuar Prokurori i Shtetit Albana Parduzi, i pandehuri A.SH., mbrojtësi i tij sipas detyrës zyrtare, avokat L.T..

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, të akuzuarit i është dhënë mundësia që të deklarohet lidhur me fajësinë, ashtu që në këtë seancë i akuzuari lidhur me pranimin e fajësisë ka deklaruar se e pranoj fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohem. Tutje ka theksuar se është penduar për rastin e ndodhur, kërkim falje dhe premtimin se më nuk do të përsërisë veprime të tilla.

Prokurori i Shtetit Albana Parduzi, lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se, i propozoj gjykatës që t’ia pranoj pranimin e fajësisë të pandehurit, ngase pranimi i fajësisë është dhënë në mënyrë vullnetare, konform dispozitave ligjore të nenit 242 të KPP-së, pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, pranimi i fajësisë ka mbështetje në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ndërsa lidhur me sanksionin penal, i ka propozuar gjykatës që të njëjtin ta shpallë fajtor, ashtu që me rastin e caktimit të matjes dhe llojit të dënimit që si rrethanë rënduese të merr parasysh dashjen e kryerjes së veprave penale, rrezikimin e vlerës së mbrojtur, shkallën e dëmit të shkaktuar, ndërsa si rrethanë lehtësuese të merr parasysh pranimin

e fajësisë, andaj nga të gjitha këto ti shqiptoj një dënim me të cilin do të arrihet qëllimi i dënimit, si dhe gjykata të merr parasysht se i njëjti ka qenë i dënuar edhe më parë me aktgjykim të formës së prerë për veprat penale të cilat ndërlidhen me dhunën në familje.

Mbrojtësi i të pandehurit A.SH., avokat L.T. lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar, se i propozon gjykatës që të aprovohet pranimi i fajësisë, i cili pranim është bërë pas konsultimit me mua si mbrojtës, ndërsa lidhur me sanksionin penalë i ka propozuar gjykatës që me rastin e caktimit e matjes dhe llojit të dënimit të merr parasysht si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë, pasi që i njëjti i ka ndihmuar gjykatës në vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike e po ashtu në rastin konkret i ka propozuar gjykatës që me rastin e shqiptimit të sanksionit penalë të merr parasysht neni 78 par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit mbështetet në provat të cilat i disponon kjo gjykatë si: Raporti Fillestar i incidentit i datës ..., Raportet e oficerëve të ...,Procesverbali i marrjes në pyetje për të dëmtuarën R.Sh., të dhëne në hetuesi ...,Procesverbali i marrjes në pyetje për të dëmtuarën B.Sh., të dhëne në hetuesi ...,Procesverbali i marrjes në pyetje të të pandehurit A.SH., të dhëne në hetuesi më datë ...,Urdhër për mbrojtjen e përkohshme emergjent i datës ..., si dhe shkresat tjera të lëndës. Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë të këtyre provave dhe pranimit të fajësisë, konsiderojmë se përtej çdo dyshimi është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në mënyrë vullnetare, dhe pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, duke i' u tërhequr vërejtja të akuzuarit se pas pranimit të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, por vetëm sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i akuzuari.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë së të akuzuarit dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i akuzuari A.SH, ka kryer veprën penale: Sulmi nga neni 184 paragrafi 3 nënpar 3.1 e lidhur me par.1 të KPRK-së dhe Sulmi nga neni 184 paragrafi 3 nënpar

3.1 e lidhur me par.1 të KPRK-së., e për të cilën veprë është paraparë dënimi me burgim prej gjashtë (6) muajve deri në tre (3) vjet.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 dhe 70 të KPRK-ës. Gjkata, si rrethanë lehtësuese ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale nga i akuzuari në seancën e shqyrtimit fillestar, keqardhjen e shprehur për atë se çfarë ka ndodhur, dhe premtimin se nuk do të përsërisë më veprime të tilla. Ndërsa, si rrethana rënduese, gjeti dashjen e lartë të kryesit në kryerjen e veprave penale, faktin se veprat penale janë kryer brenda marrëdhënies familjare, i akuzuari aktualisht gjendet në vuajtje të dënimit sipas Aktgjykimit P.nr.81/24 i plotëfuqishëm me datën 23.07.2024 për veprat penale Dhuna në familje nga neni 248 par. 3 i KPRK-së, Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 3 pika 3.1 KPRK-së dhe Kanosje nga neni 181 par 4 i KPRK-së. Këtë rrethanë gjykata e vlerësoi si rrethanë rënduese, pasi që është indikator se i akuzuari ka kryer vazhdimisht vepra penale të kësaj natyre.

Gjkata vlerëson se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e aktgjykimit, është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit. Po ashtu gjykata vlerëson se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit, i cili parashihet me nenin 38 të KPRK-së, që të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, duke vlerësuar se i akuzuari do të përmbahet nga veprimet e paligjshme në të ardhmen.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata e mori në kuptim të nenit 449 par 2 nën par 2.1 dhe 2.6 dhe nenit 452 të KPP-së. Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 36 par. 3 nën. par 3.1 të Ligjit nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Në bazë të nenit 462 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-së, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 364, 452 dhe 462 të KPPK-ës, nga arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.203/2024, datë 11.10.2024

Gjyqtarja e vetme gjykuese

Marigona LAJQI

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh prej ditës së pranimi të këtij aktgjykimi përmes kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.